

V E N D I M
Nr.38, datë 31.1.1994

PËR TRAJTIMIN E NDIHMAVE HUMANITARE FALAS

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për trajtimin e ndihmave humanitare falas të të gjitha llojeve, të cilat jepen nga organizata joqeveritare, kombëtare, ndërkombëtare ose shqiptare dhe individë a grupe individësh, që në vijim do të quhen "dhurues", krijohet Komisioni qeveritar bashkërendues për ndihmat humanitare, që në vijim do të quhet "Komisioni", i cili do të ndihmojë dhuruesit për të përmbushur sa më mirë misionin e tyre humanitar.

2. Komisioni përbëhet nga përfqësues të aparatit të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Industrisë dhe të Tregtisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Ministrisë së Arsimit e Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Përbërja e Komisionit miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimeve të titullarëve të dikastereve përkatëse.

3. Komisioni ka këto detyra kryesore:

- Bashkërendon punën ndërmjet dhuruesve dhe organeve shtetërore e organizatave a shoqatave shqiptare jofitimprurëse që në vijim do të quhen "përfitues të ndihmave", për pritjen dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare falas.

- Informon dhe u sugjeron dhuruesve për gjendjen dhe nevojat për shpërndarjen e ndihmave në zonat më të varfëra, duke u siguruar listat emërore të kryefamiljarëve.

- Siguron lehtësi pune për dhuruesit, në mënyrë që ata të veprojnë shpejt e me efektivitet. Për këtë ai merr masat përkatëse në marrëveshje me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore.

- I raporton Këshillit të Ministrave për sasinë e ndihmave humanitare të mbërritura, sasinë dhe gjeografinë e shpërndarjes së tyre.

- Të njohë e verifikojë cilësinë dhe seriozitetin e dhuruesve, që të parandalohen veprimtaritë johumanitare dhe për qëllime fitimi. Kur është e nevojshme, të njoftojë organet e specializuara për këto veprimtari.

4. Nga magazinat që sot për sot janë në përdorim të rezervës shtetërore në Lundër, Komisioni të kalojë në përdorim pa shpërbllim dhe me afat deri në 3 muaj, 6 magazina dhuruesve, sipas vëllimit të ndihmave që ata sjellin.

Komisioni lidh me dhuruesit kontratat përkatëse për përdorimin e këtyre magazinave. Afatet e kontratave mund të zgjaten tej afatit të mësipërm, në varësi nga vëllimi i ndihmave që sjellin dhuruesit.

5. Personeli i dhuruesve përjashtohet nga pagimi i taksës së vizës, taksës së hyrjes dhe taksës së kalimit të kufirit shtetëror, në përputhje me ligjin "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë". Për këtë ky personel, i huaj a shqiptar i dhuruesve, pajiset me fletidentitetin përkatës. Komisioni përcakton kriteret, mbi bazën e të cilave lëshohet fletidentiteti, që jepet për një afat deri në një vit me të drejtë zgjatjeje.

6. Ndhimat humanitare ushqimore, mjekësore etj. duhet të jenë të shoqëruara me certifikatë cilësie. Ato nuk duhet të jenë nën nivelin e standardeve të detyrueshme shqiptare. Në rast dyshimi kryhen kontrole nga organet e standardizimit e të cilësisë dhe organet e shërbimit shëndetësor. Edhe kur ndihmat janë të shoqëruara me certifikatë cilësie, nëse ka dyshime, kryhen përsëri kontrole të përbashkëta. Dhuruesit marrin përsipër dhe përgjigjen për kthimin ose asgjësimin, për llogari të tyre, të ndihmave jashtë standardeve të detyrueshme.

7. Komisioni në raste të nevojshme ndërhyr pranë organeve kompetente për sigurimin e ndihmave gjatë transportit.

8. Ndhimat humanitare përjashtohen nga taksat ose detyrimet doganore sipas ligjit, kur Komisioni vendos dhe jep lejen përkatëse.

Për të vendosur për dhënien e lejes, në mbledhjen e Komisionit paraqiten dhe shqyrtohen këto

dokumente:

- Identiteti i dhuruesit.
- Identiteti i përfituesit të ndihmave.
- Lloji, sasia dhe cilësia e ndihmave në bazë të deklaratës së dhuruesit.
- Deklaratë e përfituesit të ndihmave që mallrat e ofruara nga dhuruesi do të trajtohen si

ndihma humanitare dhe do të shpërndahen falas.

- Dokument i përfituesit të ndihmave për mënyrën dhe zonën e shpërndarjes së ndihmave.

9. Dhuruesit që kanë plan shpërndarjeje, e kryejnë zhdoganimin në doganën e rrethit ku do të shpërndahen, pasi të kenë marrë lejen nga Komisioni. Dhuruesve që nuk kanë plan shpërndarjeje, Komisioni u sugjeron zonën e shpërndarjes së ndihmave dhe, pas marrjes së deklaratës së përfituesit të ndihmave, lëshon lejen përkatëse.

10. Ndihmat humanitare shpërndahen në destinacionet e planifikuara me mjetet e dhuruesve ose të përfituesit të ndihmave. Në rast nevojë, kur transporti me mjetet e tyre bëhet i pamundur, Komisioni merr masa për shpërndarjen e ndihmave me mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Kur dhuruesi i dërgon ndihma humanitare drejtpërdrejt Qeverisë shqiptare me kusht për shpërndarjen e tyre falas, Komisioni organizon pritjen dhe transportimin e tyre nga pikat e hyrjes për në magazina me automjetet e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ndihmat shoqërohen nga një përfaqësues i dhuruesit dhe një anëtar i Komisionit. Për magazinimin dhe shpërndarjen e ndihmës vendos Komisioni në konsultim me dhuruesin.

12. Dhuruesit përjashtohen nga taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja në përputhje me ligjin "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë".

13. Sigurimi i magazinave të dhuruesve në Lundër bëhet nga vetë dhuruesit me roja civile të armatosura në përputhje me ligjin "Për rojat civile".

14. Në numrin e punonjësve në organikë të aparatit të Këshillit të Ministrave shtohet një punonjës (sekretar) për nevojat e Komisionit.

15. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.33, datë 25.1.1992 "Për trajtimin e ndihmave të jashtme", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi